


REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË  
NR. 9162 Rep.  
NR. 2096 Kol.



**KONTRATË SHITESË KONCESIONI  
PËR DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË  
FORMËS “BOT” PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE  
KUKUR 1, KUKUR 2, KUKUR 3, KUKUR 4, KUKUR 5**

Në Tiranë më datë 13, muaji Gusht, viti 2013 (Dymijë e Trembëdhjetë),  
para meje noter **JULIAN ZHELEGU**, anëtar i dhomës së Noterisë TIRANË, me  
adresë Rr. Pjetër Bogolani, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**, që më poshtë do të quhet  
“**AUTOR TET KONTRAKTUES**”, përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të  
Ministrave nr. 806, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për  
dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kukur 2”, dhe miratimin e bonusit në  
procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, përfaqësuar nga z. Florjon  
Mima, i datëlindjes \_\_\_\_\_ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për  
identitetin e të cilit u sigurova nga \_\_\_\_\_

**DHE**

**Shoqëria koncesionare “Kukur Energy” sh.p.k.**, e cila figuron e regjistruar si person  
juridik në QKR me NIPT K92313017A dhe date 13.11.2009, përfaqësuar nga z. Carlo  
Francione, i datëlindjes \_\_\_\_\_ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për  
identitetin e të cilit u sigurova nga Karta e identitetit nr. \_\_\_\_\_

**Palët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:**

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së koncesionit  
të formës BOT, të nënshkruar nga palët Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës  
dhe Bashkimit të Shoqërive “Electroimpianti Tecnoluce” srl & “Abaco Energia Pulita”  
srl, për ndërtimin e hidrocentraleve “Kukur 1” & “Kukur 2” & “Kukur 3” & “Kukur 4” &  
“Kukur 5” miratuar VKM nr. 702, datë 11.06.2009.



## Hyrje

### Duke pasur parasysh që:

Në VKM nr. 448, datë 16.06.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 27, datë 19.01.2007, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij" është parashikuar se "...Autoriteti Kontraktor, në bazë të një vlerësimi, mund të japë një afat deri në 12 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet deri në 5 MW, deri 18 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet nga 5 deri 20 MW dhe deri në 24 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion mbi 20 MW, për marrje lejeje dhe përgatitje projekti" dhe "...Të gjitha shoqëritë koncesionare, të cilat, deri në hyrjen të fuqi të këtij vendimi, nuk e kanë parashikuar afatin e nevojshëm të marrjes së këtyre lejeve në kontratat koncesionare përkatëse, kanë të drejtë ta shtyjnë afatin....

.... Shtyrja e afatit të pasqyrohet, për çdo rast, në kontratat shitesë të palëve në koncesion. Ministri përgjegjës i miraton këto kontrata, të cilat hyjnë në fuqi me firmosjen e saj nga palët."

- në nenin 10.2 është parashikuar afati 12 muaj për marrjen e lejeve.(pika 5 (b), e Udhëzimit).
- Referuar Pikës 7, të Udhëzimit Nr.873, datë 13.12.2010 "Për përcaktimin e kritereve për shtyrjen e afateve të përgatitjes së projekteve të zbatimit dhe marrjes së lejeve në kontratat koncesionare të miratuara", koncesionari ka të drejtë të përfitojë **12 muaj shitesë afati** për vënien në shfrytëzim të hidrocentraleve "Kukur 1" & "Kukur 2" & "Kukur 3" & "Kukur 4" & "Kukur 5".
- Neni 10, pika 3, e Kontratës së Konçesionit parashikon se afatin për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve mund të zgjatet në marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre;
- Palët njohin dhe pranojnë se Konçesionarit i janë shkaktuar vonesa në miratimin e projektit të zbatimit, përtej kohës së rregullt procedurale, siç parashikohet në nenin 10, pika 3, të Kontratës së Konçesionit;

Në Kontratën e koncesionit të formës BOT për ndërtimin e hidrocentraleve "Kukur 1" & "Kukur 2" & "Kukur 3" & "Kukur 4" & "Kukur 5", miratuar VKM nr. 702, datë 11.06.2009, të bëhen këto ndryshime:

## Neni 1

Në nenin 10, "Programi i punimeve":

Pika 1 zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

"Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 72 (shtatedhjetedy) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit. Afati i ndërtimit është 15 (pesembeljhete) muaj si e parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 1, bashkëlidhur."

## Neni 2

Kjo kontratë shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata shtesë e koncesionit u hartua në 4 (kater) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi u lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe me noteria e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

## PALËT

### AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë  
dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga

z. Florjor MIMA



NOËR  
JULIAN ZHELEGU

### SHOQËRIA KONCESIONARE

"Kukur Energy" sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

z. Carlo FRACIONI

